



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

# PLANI I VEPRIMIT

## POST COVID-19

(Korrik-Dhjetor)



**Përgatiti:**

**Elvira DUSHKU**

**Sekretare e Përgjithshme, FBK**

**15.06.2020, Prishtinë**

[www.basketbolli.com](http://www.basketbolli.com)





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

## Përmbajtja

1. Përmbledhje ekzekutive
2. Hyrje
- 2.1 *Rreth Planit të Veprimit Post Covid-19*
3. Gjendja aktuale në Federatën e Basketbollit të Kosovës
4. Grupet e Interesit
5. Analiza SWOT
6. Objektivat Strategjike
7. Garat e FBK-së
8. Klubet
9. Aktivitetet e Përfaqësueseve të Kosovës
10. Aktivitetet për gjyqtarë/vëzhgues
11. Projektet Zhvillimore
12. Ngritja e kapaciteteve njerëzore
13. Udhëtimet zyrtare
14. Të tjera
15. Përmbledhje
16. Rekomandime

[www.basketbolli.com](http://www.basketbolli.com)





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

## 1. Përmbledhje ekzekutive

Përhapja e pandemisë COVID-19 ka ndikuar në çdo fushë të jetës jo vetëm në Kosovë, por në të gjithë rruzullin tokësor. Qeveritë anembanë botës kanë pasur qasje të ndryshme në luftimin e pandemisë COVID-19 të cilat kanë sjellë rezultate të ndryshme. Përveç që shkatërrimi i ka kapluar të gjitha vendet e botës dhe ua ka ndryshuar tërë rrjedhën e tyre të veprimit, njerëzit është dashur të përshtaten me realitetin e ri të pasigurt i cili tani po analizohet, duke qenë të vetëdijshëm se ndikimi i plotë ende nuk është kuptuar tërësisht.

Institucionet e Kosovës kanë vendosur një sërë masash që nga 13 marsi 2020 kur filluan me karantinimin e komunave kur edhe u konfirmuan rastet e para me COVID-19.

Në të njëjtën ditë me vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës janë pezulluar të gjitha aktivitetet sportive, ndërsa që nga data 16 mars stafi i zyrës ekzekutive ka filluar punën nga shtëpia.

Më 31 mars Bordi i FBK-së ka marr vendim për anulimin e garave në dy kompeticione seniore, Superligën e Meshkujve dhe Superligën e Femrave, duke mos i shpallur kampionët e këtyre garave.

Më 8 prill Bordi i FIBA Evropës i ka anuluar 16 Kampionatet Evropiane, si dhe aktivitetet tjera të parapara gjatë kësaj vere, derisa disa takime të tjera i ka shtyrë për periudhën shtator-dhjetor.

Më 19 maj Bordi i FBK-së ka marr vendim për anulimin e garave të tjera seniore, si Liga e Parë e Meshkujve, Liga e Dytë e Meshkujve dhe Liga e Parë e Femrave, duke mos i shpallur kampionët e këtyre garave, si dhe duke vendosur për plasmanin përfundimtar të këtyre ligave.

Më 10 qershor Bordi i FBK-së ka marr vendim për anulimin e garave të grupmoshave të reja, duke mos i shpallur kampionët e këtyre garave.

[www.basketbolli.com](http://www.basketbolli.com)





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Federata e Basketbollit të Kosovës që nga fillimi i pandemisë ka qenë në kontakt të vazhdueshëm me institucionet e vendit, me FIBA dhe FIBA Evropën, me klubet anëtare të saj, si dhe me grupet tjera të interesit të FBK-së, duke qenë vazhdimisht e pranishme në media të shkruara dhe ato elektronike. Gjithashtu FBK ka qenë shumë aktive në faqen e saj zyrtare dhe në rrjetet sociale, duke e promovuar basketbollin nëpërmjet kampanjave të ndryshme të FIBA-s edhe gjatë kësaj kohe të vështirë dhe në të njëjtë kohë duke u munduar të motivojë të gjithë basketbollistët/basketbollistet dhe trajnerët/trajneret që të vazhdojnë të punojnë nga shtëpitë e tyre.

Federata e Basketbollit të Kosovës asnjëherë nuk është ndalur së punuari dhe gjatë kësaj periudhe kur nuk ka pasur aktivitete në terren FBK ka filluar punën në dy projekte madhore, siç janë nisja e procesit të hartimit të Planit Strategjik të FBK-së 2021-2025 me asistencë të FIBA-s dhe FIBA Evropës, si dhe ka filluar projektin e jetësimit të Ligës së Përbashkët Kosovë - Shqipëri, derisa në koordinim me Shoqatën e Trajnerëve të Basketbollit në Kosovës (SHTBK) ka punuar në kriteret për licencim të trajnerëve, klubeve dhe shkollave të basketbollit.

FBK ka hartuar Udhëzuesin për Rikthimin në Fushat e Basketbollit për ekipet që janë të interesuara të fillojnë me stërvitje, të cilin është duke e përditësuar varësisht prej situatës me COVID-19.

FBK gjithashtu ka vendosur që për shkaqe ekonomike të ndërpresë kontratat e punës me marrëveshje me tre anëtarë të stafit të zyrë ekzekutive, derisa prej muajit prill stafi i zyrës ekzekutive është duke punuar me pagë të përgjysmuar.

[www.basketbolli.com](http://www.basketbolli.com)





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

## 2. Hyrje

### 2.1 Rreth Planit të Veprimit Post Covid-19

Federata e Basketbollit të Kosovës e ka pasur Planin e saj të Veprimit 2020 në bazë të të cilit ka vepruar deri më 13 mars kur edhe janë pezulluar të gjitha aktivitetet sportive me vendim të Qeverisë së Kosovës për shkak të pandemisë COVID-19, dhe kur është “izoluar” e gjitha bota për shkak të këtij virusi.

Tani është krijuar një realitet i ri jo vetëm në Federatën e Basketbollit të Kosovës por në të gjithë botën, andaj është më se e domosdoshme analiza e Planit të Veprimit 2020 dhe krijimi i një Plani të Veprimit Post Covid-19 në mënyrë që të bëhet edhe renditja e aktiviteteve të FBK-së, por edhe të parashtrihen objektivat strategjike për 6 muajt e ardhshëm aq sa kanë mbetur nga ky vit.

Karakteristikat e virusit COVID-19 nuk janë plotësisht të kuptueshme dhe për këtë arsye është e mundur që çdo fazë të planifikuar nga Qeveria kufizimet të futen përsëri në agjendë. Kjo është arsyeja që ne duhet të vazhdojmë të jemi të disiplinuar dhe të kemi kujdes të madh, por në të njëjtën kohë duhet të qëndrojmë të gatshëm edhe për vendime të tjera të Qeverisë në rast se pandemia do të jetë e pranishme edhe në muajt e tjerë të këtij viti, siç është zhvillimi i ndeshjeve pa shikues, si dhe marrja e një sërë masash të tjera për zhvillimin e aktiviteteve sportive të cilat në mënyrë direkte do të ndikojnë në buxhetin e ekipeve dhe grupeve tjera të interesit të FBK-së.

Sidoqoftë Bordi i FBK-së në krye me Kryetarin e FBK-së dhe Sekretaren e Përgjithshme të FBK-së do të veprojnë konform vendimeve të Qeverisë dhe në shërbim të anëtarëve të saj.

Për Federatën e Basketbollit të Kosovës prioritet është shëndeti i të gjithë njerëzve që janë pjesë e komunitetit të basketbollit e më gjerë.

[www.basketbolli.com](http://www.basketbolli.com)





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

### 3. Gjendja aktuale në Federatën e Basketbollit të Kosovës

Federata e Basketbollit të Kosovës e ka hapur zyrën e saj më 1 qershor dhe kjo pas lehtësimit të masave nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Në këtë fazë FBK-ja do të punojë me staf të përgjysmuar, ku një pjesë e anëtarëve të stafit do të punojnë nga zyra dhe një pjesë nga shtëpitë, si dhe kjo do të bëhet me rotacion ndërmjet anëtarëve të stafit, përderisa Sekretarja e Përgjithshme do të jetë çdo ditë të javës në punë në zyre.

Sponsorët kryesorë të FBK-së, Banka TEB, Art Motion, Stobi Flips dhe Korporata Rugove kanë qëndruar me FBK-në gjatë kësaj periudhe të vështirë dhe kanë premtuar se do ta bëjnë edhe në vazhdim një gjë të tillë.

Po ashtu Ministria për Kulturë, Rini dhe Sport e Kosovës i ka kryer obligimet e saj të deritashme konform Memorandum Bashkëpunimit të nënshkruar në muajin prill dhe pritet që ta bëjë të njëjtën gjë edhe në vazhdim.

Gjendja në klube ende nuk dihet saktësisht, por ajo që dihet është se pothuajse të gjitha skuadrat presin ndihmë nga Qeveria e Kosovës nëpërmjet pakos emergjente të premtuar në muajin mars, si dhe nga qeveritë lokale prej nga vijnë këto klube.

Sa i përket raporteve klube - basketbollistë/e dhe kontratave të tyre të cilat janë ndërprerë në mars për shkak të pezullimit të aktiviteteve sportive deri më tani në bazë të deklaratave të klubeve gjendja nuk është aq e rëndë, por se nuk është edhe aq shumë premtuese pasi që ka basketbollistë, sidomos vendorë që në media janë shprehur të zhgënjyer me situatën në të cilën ndodhen, por që ende zyrtarisht në FBK askush nuk është ankuar apo ka paraqitur kërkesë për ndihmë në këtë aspekt.

Gjendja financiare në FBK vazhdon të jetë shumë e rëndë, me deficit prej rreth 350,000.00 Euro.

[www.basketbolli.com](http://www.basketbolli.com)





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

#### 4. Grupet e Interesit

- Kuvendi;
- Klubet;
- Shoqatat;
- Komisionet;
- Bordi i FBK-së;
- Zyra Ekzekutive e FBK-së;
- FIBA;
- Federatat Nacionale;
- Ekspertët e brendshëm dhe të jashtëm;
- Federatat tjera në Kosovë;
- Qeveria e Republikës së Kosovës;
- Ministria për Kulturë, Rini dhe Sport;
- Departamenti i Sporteve të Kosovës;
- Komunat;
- Policia e Republikës së Kosovës;
- Partneri medial, ART MOTION;
- Mediat (e shkruara dhe elektronike);
- Sponsorët aktual dhe ata potencial;
- Baker Tilly (Kontabiliteti-FBK);
- Të gjithë adhuruesit e basketbollit që pritet të jenë të pranishëm në ndeshjet e basketbollit.

[www.basketbolli.com](http://www.basketbolli.com)





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

## 5. Analiza SWOT

<p style="text-align: center;"><b>Pikët e forta</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Basketbolli, sport i popullarizuar;</li> <li>- Vullnet i madh nga Federata e Basketbollit të Kosovës për të punuar në sanimin e gjendjes Post Covid-19;</li> <li>- Imazh pozitiv i FBK-së në FIBA;</li> <li>- Imazhi pozitiv i FBK-së tek Ambasadat e huaja në Kosovë;</li> <li>- Përfaqësuesja e Kosovës në gara ndërkombëtare;</li> <li>- Zyra Ekzekutive në rritje profesionale;</li> </ul>	<p style="text-align: center;"><b>Pikët e dobëta</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Mungesa e infrastrukturës;</li> <li>- Mungesa e trajnerëve 100% të fokusuar në basketboll;</li> <li>- Mungesa e ekspertëve vendor;</li> <li>- Mungesa e financave;</li> </ul>
<p style="text-align: center;"><b>Mundësitë</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Interesimi i fëmijëve për të praktikuar basketbollin;</li> <li>- Rrjetet sociale, interneti dhe website;</li> <li>- Projektet zhvillimore;</li> <li>- Përkrahja nga Qeveria;</li> <li>- Bashkëpunim i mirë i FBK-së me Federatat tjera Nacionale;</li> </ul>	<p style="text-align: center;"><b>Kërcënimet</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- COVID-19;</li> <li>- Mungesa e sigurimit të sponsorëve;</li> <li>- Mospërkrahja e duhur nga institucionet;</li> <li>- Konkurrenca nga sportet tjera;</li> <li>- Infrastruktura dhe mjedisi;</li> </ul>

[www.basketbolli.com](http://www.basketbolli.com)







FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

## 6. Objektivat Strategjike

### *Objektivat Strategjike të FBK-së për Korrik - Dhjetor:*

- Zhvillimi i mëtutjeshëm i brendit të Federatës së Basketbollit të Kosovës;
- Fillimi i Ligës së Përbashkët, Kosovë - Shqipëri;
- Sigurimi i mbështetjes financiare nga Qeveria për projektin e Ligës së Përbashkët;
- Vazhdimi i bashkëpunimit me sponsorët aktual;
- Sigurimi i sponsorit të Superligës;
- Sigurimi i sponsorit teknik të Përfaqësueses A të Kosovës;
- Zvogëlimi i borxhit aktual të FBK-së (30-50%);
- Hartimi i Planit Strategjik të FBK-së 2021-2025;
- Vazhdimi i suksesit me Përfaqësuesen A të Kosovës dhe rritja e brendit të Përfaqësueses;
- Fillimi i punës në ndërtimin e Përfaqësueses A të Femrave;
- Digjitalizimi i FBK-së;
- Rritja e prezencës së sportit të basketbollit në media;
- Fillimi i procesit të licencimit të shkollave të basketbollit që veprojnë në Kosovë;
- Fillimi i procesit të ri të licencimit të trajnerëve;
- Fillimi i një edukimi bazik për trajnerët në Kosovë;
- Fillimi i projektit të Mini-Basketbollit në Kosovë dhe fillimi i një edukimi për trajnerët;
- Fillimi i projektit 3x3 me mbikëqyrje direkte të FBK-së;
- Vazhdimi i projekteve me FIBA dhe Ambasadat e huaja në Kosovë për promovimin e basketbollit ndër vajza dhe komunitete të tjera që jetojnë në Kosovë;
- Zhvillimi i kapaciteteve menaxhuese dhe kuadrove të tjera të FBK-së;

[www.basketbolli.com](http://www.basketbolli.com)





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

## 7. Garat e FBK-së

- Organizimi i garave në kategorinë seniore në të dyja konkurrencat;
- Organizimi i garave në kategoritë e reja në të dyja konkurrencat;
- Organizimi i Final 8 Kupës së Kosovës;
- Organizimi i Ligës së Përbashkët Kosovë – Shqipëri;
- Organizimi i Superkupës së Kosovës;

### Plani i Veprimit

<b>Veprimi (Çfarë)</b>	<b>Detyra (Si)</b>	<b>Përgjegjësi (Kush)</b>	<b>Afatet (Kur)</b>	<b>Burime</b>
<i>Organizimi i garave në kuadër të FBK-së dhe në bashkëpunim me FSHB</i>	<i>Nëpërmjet ligave të ndara në kategori dhe në dy konkurrenca, dhe ligës së përbashkët me FSHB</i>	<i>Komesari i Garave  Sekretari i Përgjithshëm</i>	<i>Korrik – Dhjetor</i>	<i>FBK  MKRS  Sponsorët  FSHB</i>

[www.basketbolli.com](http://www.basketbolli.com)





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

## Kontrolli dhe Vlerësimi

Objektivat	Indikatorët që do të kontrollohen	Qëllimi	Mënyra e mbledhjes së informacionit	Frekuencat Kur	Përgjegjës
<i>Ngritja e cilësisë dhe interesimit për basketboll dhe interesimit për përkrahje nga sponsorët dhe qeveritë</i>	<i>Klubet Trajnerët Basketbollistët Basketbollistët</i>	<i>Përfshirja e basketbollit nëpër të gjitha regjionet e Kosovës, Shqipërisë dhe më gjerë</i>	<i>Në bazë të informatorëve të Komesarëve të Garave dhe raporteve të punës</i>	<i>Në baza javore dhe mujore</i>	<i>Kryetari i FBK-së  Bordi i FBK-së</i>



[www.basketbolli.com](http://www.basketbolli.com)





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

## 8. Klubet

- Liga e Përbashkët, Kosovë-Shqipëri
- Garat ndërkombëtare;

### Plani i Veprimit

<b>Veprimi (Çfarë)</b>	<b>Detyra (Si)</b>	<b>Përgjegjësi (Kush)</b>	<b>Afatet (Kur)</b>	<b>Burime</b>
<i>Participimi i 4 ekipeve nga Kosova në projektin e përbashkët;  Participimi i ekipeve nga Kosova në FIBA Europe Cup</i>	<i>Në bazë të rezultateve të arritura në gara vendore</i>	<i>Klubet</i>	<i>Janar – Dhjetor</i>	<i>Sponsorët  MKRS  FBK  FSHB  FIBA  Komunat</i>

[www.basketbolli.com](http://www.basketbolli.com)





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

## Kontrolli dhe Vlerësimi

Objektivat	Indikatorët që do të kontrollohen	Qëllimi	Mënyra e mbledhjes së informacionit	Frekuencat Kur	Përgjegjës
<i>Ngritja e cilësisë së ekipeve kosovare dhe rritja e konkurrencës</i>	<i>Klubet në tërësi</i>	<i>Rezultate pozitive</i>	<i>Në bazë të rezultateve</i>	<i>Në baza javore dhe mujore</i>	<i>Bordi i FBK-së Sekretari i Përgjithshëm</i>



[www.basketbolli.com](http://www.basketbolli.com)





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

## 9. Aktivitetet e Përfaqësueseve të Kosovës

- Grumbullimi disa ditor i Përfaqësueses A të Kosovës në muajin gusht në Prishtinë;
- Përfaqësuesja A e Kosovës në nëntor do t'i luaj dy ndeshjet e parakualifikimeve evropiane për Kupën e Botës 2023 kundër Sllovakisë më 26 nëntor dhe Islandës më 29 nëntor;
- Grumbullimi disa ditor i Përfaqësueseve të Reja të Kosovës;
- Fillimi i ndërtimit të Përfaqësueses A të Femrave dhe synimi për pjesëmarrje në FIBA Kampionatin Evropian të Shteteve në Zhvillim që do të organizohet vitin e ardhshëm;

### Plani i Veprimit

<b>Veprimi (Çfarë)</b>	<b>Detyra (Si)</b>	<b>Përgjegjësi (Kush)</b>	<b>Afatet (Kur)</b>	<b>Burime</b>
<i>Grumbullimet dhe pjesëmarrja e Përfaqësueses së Kosovës në gara zyrtare të FIBA-s</i>	<i>Nëpërmjet parakualifikimeve evropiane për Kupën e Botës 2023</i>	<i>Drejtori i Përfaqësueseve të Kosovës</i>	<i>Gusht Nëntor</i>	<i>FBK MKRS FIBA Sponsorët</i>

[www.basketbolli.com](http://www.basketbolli.com)





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

## Kontrolli dhe Vlerësimi

<b>Objektivat</b>	<b>Indikatorët që do të kontrollohen</b>	<b>Qëllimi</b>	<b>Mënyra e mbledhjes së informacionit</b>	<b>Frekuencat Kur</b>	<b>Përgjegjës</b>
<i>Përgatitje sa më kualitative dhe triumfi në dy ndeshjet e nëntorit</i>	<i>Trajnerët Basketbollistët Basketbollistet</i>	<i>Ngritja e imazhit të basketbollit kosovar në arenën ndërkombëtare</i>	<i>Në bazë të raporteve të Drejtorit të Përfaqësueseve dhe trajnerëve</i>	<i>Në baza javore, mujore, vjetore</i>	<i>Kryetari i FBK-së Bordi i FBK-së Sekretari i Përgjithshëm</i>

[www.basketbolli.com](http://www.basketbolli.com)





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

## 10. Aktivitetet për gjyqtarë/vëzhgues

- Trajnimet online të organizuara nga FIBA Europe;
- SCOD seminari për gjyqtarë dhe vëzhgues;
- Organizimi i testeve për gjyqtarë dhe vëzhgues para fillimit të edicionit të ri;
- Organizimi i Klinikës për gjyqtarët/vëzhguesit para fillimit të Ligës së Përbashkët;
- Mbajtja e Klinikës për Statistika;

### Plani i Veprimit

<b>Veprimi (Çfarë)</b>	<b>Detyra (Si)</b>	<b>Përgjegjësi (Kush)</b>	<b>Afatet (Kur)</b>	<b>Burime</b>
<i>Zhvillimi i gjyqtarëve kosovarë</i>	<i>Nëpërmjet klinikave</i>	<i>Koordinatori Nacional i FBK-së</i>	<i>Korrik – Dhjetor</i>	<i>FBK MKRS FIBA Sponsorët</i>

[www.basketbolli.com](http://www.basketbolli.com)







FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

## Kontrolli dhe Vlerësimi

Objektivat	Indikatorët që do të kontrollohen	Qëllimi	Mënyra e mbledhjes së informacionit	Frekuencat Kur	Përgjegjës
Ndarja cilësore e drejtësisë në të gjitha ligat	Gjyqtarët Vëzhguesit Koordinatori Nacional i FBK-së	Të kemi gjyqtarë dhe vëzhgues cilësorë	Në bazë të raporteve të Koordinatorit Nacional si dhe evaluimit personal të gjyqtarëve	Në baza javore, mujore, vjetore	Bordi i FBK-së Sekretari i Përgjithshëm

[www.basketbolli.com](http://www.basketbolli.com)





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

## 11. Projektet zhvillimore

- Minibasketbolli në Kosovë;
- Basketbollit 3x3;
- FIBA YDF Program;
- FIBA Europe Girls Program;
- Kampi Nacional i FBK-së;

### Plani i Veprimit

<b>Veprimi (Çfarë)</b>	<b>Detyra (Si)</b>	<b>Përgjegjësi (Kush)</b>	<b>Afatet (Kur)</b>	<b>Burime</b>
<i>Masovizimi Identifikimi Mbetja në basketboll Zhvillimi Organizimi</i>	<i>Nëpërmjet pjesëmarrjes në turne, kampe, klinika, si dhe organizimeve në vendin tonë të aktiviteteve me karakter ndërkombëtar</i>	<i>Drejtori i Përfaqësueseve të Kosovës  Kordinatorët/et e projekteve</i>	<i>Korrik – Dhjetor</i>	<i>FBK MKRS FIBA Komunat</i>

[www.basketbolli.com](http://www.basketbolli.com)





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

## Kontrolli dhe Vlerësimi

<b>Objektivat</b>	<b>Indikatorët që do të kontrollohen</b>	<b>Qëllimi</b>	<b>Mënyra e mbledhjes së informacionit</b>	<b>Frekuencat Kur</b>	<b>Përgjegjës</b>
<i>Të rritet numri i djemve dhe vajzave që e praktikojnë basketbollin</i>  <i>Të rritet numri i djemve dhe vajzave të moshës prej 5 deri në 10 vjeç që e praktikojnë basketbollin</i>	<i>Koordinatorët/et</i> <i>Trajnerët/et</i> <i>Basketbollistët</i> <i>Basketbollistët</i>	<i>Fëmijët të mbeten në basketboll</i>	<i>Në bazë të raporteve të Koordinatorëve</i>	<i>Në baza javore, mujore, vjetore</i>	<i>Kryetari i FBK-së</i>  <i>Sekretari i Përgjithshëm</i>

[www.basketbolli.com](http://www.basketbolli.com)





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

## 12. Ngritja e kapaciteteve njerëzore

- Organizimi i seminareve/klinikave për trajnerë;
- Edukimi bazik për trajnerët e basketbollit;
- Edukimi dhe shkollimi i stafit të zyrës ekzekutive në FIBA Time Out 2.0 Program;

### Plani i Veprimit

<i><b>Veprimi (Çfarë)</b></i>	<i><b>Detyra (Si)</b></i>	<i><b>Përgjegjësi (Kush)</b></i>	<i><b>Afate (Kur)</b></i>	<i><b>Burime</b></i>
<i>Investimi në kuadro dhe kthimi prapa i këtij investimi</i>	<i>Nëpërmjet pjesëmarrjes në Punëtori, Klinika dhe Seminare</i>	<i>Sekretari i Përgjithshëm</i>	<i>Korrik – Dhjetor</i>	<i>FBK MKRS FIBA</i>

[www.basketbolli.com](http://www.basketbolli.com)





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

## Kontrolli dhe Vlerësimi

<b>Objektivat</b>	<b>Indikatorët që do të kontrollohen</b>	<b>Qëllimi</b>	<b>Mënyra e mbledhjes së informacionit</b>	<b>Frekuencat Kur</b>	<b>Përgjegjës</b>
<i>Të rritet cilësia tek kuadrot</i>	<i>Trajnerët Stafi i zyrës ekzekutive</i>	<i>Të arrihet profesionalizmi</i>	<i>Në bazë të raporteve të aktiviteve</i>	<i>Në bazë të aktiviteve</i>	<i>Kryetari Bordi i FBK-së</i>

[www.basketbolli.com](http://www.basketbolli.com)





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

### 13. Udhëtimet zyrtare

- Pjesëmarrja në Takimin Vjetor të Sekretarëve të Përgjithshëm të FIBA Evropës;
- Pjesëmarrja në FIBA Asamblenë e Përgjithshme të FIBA Evropës;
- Pjesëmarrja në aktivitetin FIBA U14 Get Together;
- Pjesëmarrja në shortin e Përfaqësuesve të Reja;

### Plani i Veprimit

<i><b>Veprimi (Çfarë)</b></i>	<i><b>Detyra (Si)</b></i>	<i><b>Përgjegjësi (Kush)</b></i>	<i><b>Afatet (Kur)</b></i>	<i><b>Burime</b></i>
<i>Udhëtime me karakter të “networking”</i>	<i>Nëpërmjet pjesëmarrjes në aktivitete</i>	<i>Sekretari i Përgjithshëm</i>	<i>Shtator - Dhjetor</i>	<i>FBK MKRS FIBA</i>

[www.basketbolli.com](http://www.basketbolli.com)





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

## Kontrolli dhe Vlerësimi

Objektivat	Indikatorët që do të kontrollohen	Qëllimi	Mënyra e mbledhjes së informacionit	Frekuencat Kur	Përgjegjës
<i>Prezantim sa më i mirë i FBK-së</i>	<i>Zyrtarët e FBK-së</i>	<i>Bashkëpunimi me Federatat tjera Nacionale</i>  <i>Zhvillimi i projekteve të përbashkëta</i>	<i>Në bazë të raporteve të aktiviteteve</i>	<i>Në bazë të aktiviteteve</i>	<i>Bordi i FBK-së</i>

[www.basketbolli.com](http://www.basketbolli.com)





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

## 14. Të tjera

- Plani Strategjik 2021-2025;
- Organizimi i seminarit për menaxhim të klubeve;

### Plani i Veprimit

<i><b>Veprimi (Çfarë)</b></i>	<i><b>Detyra (Si)</b></i>	<i><b>Përgjegjësi (Kush)</b></i>	<i><b>Afate (Kur)</b></i>	<i><b>Burime</b></i>
<i>Hartimi i Planit Strategjik të FBK-së  Qeverisja e mirë në klubet tona</i>	<i>Nëpërmjet Grupit të Punës;  Nëpërmjet pjesëmarrjes në seminare</i>	<i>Sekretari i Përgjithshëm</i>	<i>Korrik - Dhjetor</i>	<i>FBK  MKRS  KOK  FIBA</i>

[www.basketbolli.com](http://www.basketbolli.com)







FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

## Kontrolli dhe Vlerësimi

<b>Objektivat</b>	<b>Indikatorët që do të kontrollohen</b>	<b>Qëllimi</b>	<b>Mënyra e mbledhjes së informacionit</b>	<b>Frekuencat Kur</b>	<b>Përgjegjës</b>
<i>Koncepti i basketbollit në vendin tonë për katër vitet e ardhshme</i>	<i>Grupi i Punës</i>	<i>Të krijohet një qeverisje e mirë dhe stabilitet financiar</i>	<i>Në bazë të raporteve</i>	<i>Në bazë të aktiviteteve</i>	<i>Kryetari Bordi i FBK-së</i>

[www.basketbolli.com](http://www.basketbolli.com)





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

## 15. Përmbledhje

Federata e Basketbollit të Kosovës është e gatshme për pjesën e dytë të vitit 2020 e që pritet të jetë edhe më e vështirë sesa që kishim parashikuar, për shkak të shfaqjes dhe përhapjes së pandemisë COVID-19.

I gjithë fokusi i FBK-së do të jetë rimëkëmbja e vet Federatës, por edhe e anëtarëve të saj duke marr parasysh pasojat ekonomike të cilat do ti vuajmë të gjithë për shkak të rendit të rij botëror me rastin e shfaqjes së pandemisë.

Megjithatë për të tejkaluar këtë krizë, jo vetëm të FBK-së, por globale ne kemi nevojë për përkrahjen e të gjitha Grupeve të Interesit të FBK-së, të cilat luajnë rol të rëndësishëm në zhvillimin e basketbollit në vendin tonë, sepse vetëm së bashku ne mund ta zhvillojmë sportin tonë të dashur.

## 16. Rekomandime

Pandemia COVID-19 do të jetë në mesin tonë edhe për një kohë, të paktën deri në përgatitjen e vaksinës, andaj FBK në vazhdimësi do të kërkojë nga anëtarët e saj ti përmbahen udhëzimeve të insitucioneve në vendin tonë.

Karakteristikat e virusit COVID-19 nuk janë plotësisht të kuptueshme dhe për këtë arsye është e mundur që çdo fazë të planifikuar nga Qeveria kufizimet të futen përsëri në agjendë. Kjo është arsyeja që ne duhet të vazhdojmë të jemi të disiplinuar dhe të kemi kujdes të madh.

Gjithashtu rekomandohet që në fund të vitit Bordi i FBK-së të bëjë matjen e realizimit apo jot ë objektivave strategjike të këtij 6 mujori dhe të përfshijë në të përparësitë, apo edhe pengesat në të cilat ka hasur gjatë këtij procesi.

[www.basketbolli.com](http://www.basketbolli.com)

